



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**

---

Numri i lëndës: 2019:297131  
Datë: 13.09.2022  
Numri i dokumentit: 03414362

CP.nr.320/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Durim BALAJ, duke vendosur në lëndën e përbarimore të kreditorës: J. D., nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Korab Bokshi, avokat në Gjakovë, kundër debitorit Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit në Gjakovë, për shkak të pagesës së borxhit, jashtë seancës, me 13 shtator 2022, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

PËRFUNDOHET procedura përbarimore, e udhëhequr sipas shenjës CP.nr.320/2021, e iniciuar nga kreditorja e përbarimit J. D. nga Gjakova, kundër debitorës Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit në Gjakovë, për shkak të pagesës së tërësishme të borxhit nga debitori.

**A r s y e t i m**

Kreditorja e përbarimit J. D. nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës, ka paraqitur propozimin për përbarim në bazë të dokumentit ekzekutiv Aktgjykimit C.nr.1200/2019 datë 12.03.2021, i marrë nga Gjykata Themelore në Gjakovë, i ekzekutueshëm nga data 13.04.2021, kundër debitorës Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit në Gjakovë dhe i ka propozuar kësaj Gjykate që të lejoj përbarimin për shkak të borxhit të debitorit ndaj këtu kreditorës.

Gjykata Themelore në Gjakovë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorës së përbarimit, me aktvendimin CP.nr.320/2021, datë 23.06.2021, ka lejuar përbarimin ndaj debitorës Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit në Gjakovë.

Pasi aktvendimi për ekzekutim CP.nr.320/2021, i datës 23.06.2021, është bërë i ekzekutueshëm Gjykata ka nxjerrë urdhër për ekzekutim, me të cilin e ka urdhëruar Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve – Thesarin e Kosovës, që nga llogaria e debitorës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, të bëjë bartjen e mjeteve sikurse në urdhrin për ekzekutim CP.nr.320/2021, datë 27.07.2021, në llogari të autorizuarit të kreditores, avokatit Korab Bokshi.

I autorizuari i kreditores, me parashtrësën e datës 05.09.2022, ka njoftuar Gjykatën se Thesari i Kosovës, ka vepruar sipas urdhrit të Gjykatës duke i ekzekutuar mjetet për destinim për kreditoren, duke theksuar se procedura ka përfunduar në tërësi.

Meqenëse kreditorja përmes të autorizuarit të saj ka njoftuar Gjykatën, se Thesari i Kosovës ka përmbushur në tërësi obligimin ndaj kreditores të përmbarimit, Gjykata duke u bazuar në nenin 66 paragrafi 4 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, në të cilin parashihet se *“Pas përmbushjes se kredisë se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbarimore”*, vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

CP.nr.320/2021, me 13 shtator 2022

G J Y Q T A R I

Durim BALAJ

### KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të parashtrohet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.